



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:064129

Datë: 15.10.2019

Numri i dokumentit: 00577629

P. nr. 731/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja Ilirjana Hoti me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër te akuzuarit E.P. K-Gjakovë, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor në bashkëkryerje nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nën.par.1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës ,sipas aktakuzës së PTH-DP ne Gjakovë, PP.nr.1241/2017 të datës 08.03.2018, në shqyrtimin fillestar, të mbajtur më datë 15.10.2019, në prani të Prokurorit të shtetit Armend Z.aj, mbrojtësit te akuzuarit av P.P. dhe te akuzuarit E.P., te njëjtën dite morri dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **E.P.**, K Gjakovë , i biri P. dhe i nenës M. e gjinisë M., data e lindjes..., në Gjakovë, ka te kryer te shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes se dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, i pa martuar , numer personal...

J a n ë f a j t o r

Sepse :

-me dt.16.08.2017, rreth orës 12.30 min, në fsh. D., K-Gjakovë, i shkaktojnë lëndime të lehta trupore te dëmtuarit L.(Z.)L., nga Gjakovë, në atë mënyrë e nga shkak i fjalosjes verbale, lidhur me aksidentin trafikut ndodhur te njëjtin ditë, në mes te dëmtuarit e te akuzuarit M., të akuzuarit shkojnë te dyqani i fshatit e kur e shohin në dyqan te dëmtuarin, i akuzuari P. të dëmtuarit i drejtohet me fjalët “a bën një fjalë” e menjëherë e sulmon me grushte dhe e godet fytyrës te dëmtuarin e me a pas fillon përleshja, e të dëmtuarin vazhdojnë te e sulmojë fizikisht, ashtu që te akuzuarit Z. dhe M. e godasin me grusht në kokë e ne trup te dëmtuarin, ndërsa i mituri GJ.P. me armë lodër bën roje te dera dyqanit e me pas nga automjeti e merr një çelës e me te e godet pjesëve trupit te dëmtuarin si dhe i akuzuari E. e merr një çelës e me te e godet pjesëve trupit te dëmtuarin e i shkaktojnë lëndime te lehta trupore, sipas ekspertizës mjeko ligjore te Dr.N.H. dt. 30.10.2017.

- **me çka ne bashkëkryerje kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor në bashkëkryerje nga neni 188 par. 2-1 nen par1.4 lidhur me nenin 31 te KPRK-ës .**

Andaj Gjykata në bazë te nenit 4,17, 41,43,46,73 të KPRK-ës, dhe nenit 188 par 2 -1-4-31 të KPRK-së dhe nenit 365 te KPPK-së te akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Me dënim me gjobë në shumën prej **300(treqind)euro**, të cilin shumë obligohet që ta paguaj në afat prej 30 ditësh, pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim dhe në forma tjera të parapara sipas nenit 46 të KPK-së, atëherë i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej **15 (pesëmbëdhjetë) ditësh**, duke llogaritur për çdo ditë burgu prej **20,-€(njëzetë)**

I dëmtuari, për të realizuar kërkesën e vet pasurore -juridike udhëzohen në kontest civil.

I akuzuari obligohet që në emër të shpenzimeve gjyqësore dhe atë në emër të paushallit gjyqësor shumë prej **30.00 euro** në afat prej **15 ditëve**, pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë ,nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzës PP.nr.1241/17 të dt. 08.03.2018, ka akuzuar te akuzuarit P.P., M.P., E.P. dhe Z.P., të tre nga K. Gjakovë , për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor në bashkëkryerje nga neni 188 par.2-1-1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës.

Gjykata konstaton se për te akuzuarin E.P. gjykata ka veçuar procedurën penale sipas aktvendimit P.nr. 201/18 dt.17.10.2018, dhe ka lëshuar urdherarrest P.nr.201/18 me qene se i akuzuari E.P. nuk ka marr pjesë në sancen gjyqësor dt.17.10.2018, dhe nga st. policor në Gjakovë me njoftimin e dt.16.10.2018 me nr. ref. 04/1-L-08-GJ-S jemi njoftuar se i akuzuari E.P. ndodhet jashtë shtetit në Gjermani të cilën informate e kanë pranuar nga axha i tuj M.P.me nr. tel ...

I akuzuari E.P. pas marrjes së njoftimit se ndaj të njëjtit është lëshuar urdhër arrest, është paraqitur në gjykate vullnetarisht, i njëjti u procedua dhe të njëjtin i tërhiqet urdhër arresti nga gjykata.

Prokurori i shtetit Armend Z.aj, në shqyrtimin fillestar të dt.15.10.2019 lexoi aktakuzën PP.nr.1241/2017 të dt. 08.03.2018 me ç ‘rast prokurori bene leximin dhe deklaroi se mbetet në tersi pran aktakuzës, por bene përmirësimin e kualifikimit të veprës penale të kryer në bashkëkryerje ,ashtu që pas nenit 188/2 duhet të shtohet edhe paragrafi 1 nën par. 1.4 e lidhur me nenin 31 të KPRK-ës ndërsa pjesa tjetër mbete e pandryshuar..

I akuzuari E.P., gjatë shqyrtimit fillestar duke e deklaruar lidhur me fajësinë pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij av. P.P., thekson se e pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimi të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtojë se me pranimin e fajësisë në çdo fazë të procedurës jam penduar për veprën e kryer në afekt, premtojë se një veprim i tillë nuk do të përsëritet me qenë me të njëjtin jemi pajtuar, kërkojë falje para gjykatës për lëndimet e shkaktuara, andaj i propozojë gjykatës që të merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë, pendimin e shprehur e gjykatë, premtimin se në të ardhmen do të jem me i kujdesshëm, gjendjen e dobët ekonomike si dhe faktin se me parë nuk kam ra ndesh me ligjin të me shqiptojë një dënim me të butë.

Duke u deklaruar lidhur me fajësinë prokurori i shtetit Armend Z.aj, deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë pasi që i njëjti është i vetëdijshëm për pasojat dhe favorin juridike të pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bere me vullnet të mirë dhe pa presion po ashtu ky pranim i fajësisë ka mbështetje në provat dhe faktet që i janë bashkangjitur aktakuzës, andaj i propozoi gjykatës që i akuzuari të shpallet fajtor, të dënohet sipas ligjit dhe të obligohet në pagesën e shpenzimeve procedurale.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se të akuzuarit E.P., : me dt.16.08.2017 , rreth orës 12.30 min, në fsh. D. K-Gjakovë, i shkaktojnë lëndime të lehta trupore të dëmtuarit L.(Z.)L. Gjakovë, në atë mënyrë e nga shkak i fjalosjes verbale, lidhur me aksidentin trafikut ndodhur të njëjtin ditë, në mes të dëmtuarit e të akuzuarit M., të akuzuarit shkojnë te dyqani i fshatit e kur e shohin në dyqan të dëmtuarin, i akuzuari P. të dëmtuarit i drejtohet me fjalët “a bën një fjalë” e menjëherë e sulmon me grushte dhe e godet fytyrës të dëmtuarin e me a pas fillon përleshja, e të dëmtuarin vazhdojnë të e sulmojnë fizikisht, ashtu që të akuzuarit Z. dhe M. e godasin me grusht në kokë e në trup të dëmtuarin, ndërsa i mituri GJ.P. me armë lodër bën roje të dera dyqanit e me pas nga automjeti e merr një çelës e me te e godet pjesëve trupit të dëmtuarin si dhe i akuzuari E. e merr një çelës e me te e godet pjesëve trupit të dëmtuarin e i shkaktojnë lëndime të lehta trupore, sipas ekspertizës mjeko ligjore të Dr.N.H. dt. 30.10.2017.

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtarja e vetme gjykues konstatoi se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të gjykohet në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPRK-së ,të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana renduese gjykata konsideron faktin se i akuzuari në bashkryerje ka kryer veprën penale të lëndimit të lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par. 1nën par.1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ndërsa si rrethana posaçërisht lehtësuese gjykata ka marrë parasysh pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari ,sjelljen e tij korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësor, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryen vepra penale të natyrës së njëjtë, kërkim falja nga i dëmtuari për veprimet e tija, pajtimi me familjarët e të dëmtuarit sipas traditave, premtimi i tij se në të ardhmen do të jetë më të kujdesshëm, si dhe faktin se i akuzuari me pare nuk kanë qenë të dënuar nga ana e gjykatës, të gjitha këto ndikuan që Gjykata ka ardhur në përfundim që të akuzuarit të shqiptoj dënim me gjobë në shumë prej **300 (treqind) euro**, me të cilin dënim do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 të KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimin i shqiptuar do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të

ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij ,do të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për udhëzimin e palës se dëmtuar ne kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marr bazuar ne nenin 463/2 te KPP-ës.

Vendimi mbi shpenzimet procedurës penale dhe paushalli gjyqësor në shumë prej nga 30,00 € ,është bazuar në dispozitat e nenit 450 par.1dhe 2 nën paragrafi 2.6 te KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr. 731/18 datë 15.10.2019.**

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund te paraqitet ankesë, në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e marrjes se tij ne dorëzim ,Gjykatës së Apelit ne Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.